



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AGJENCIA KOMBËTARE BËRTHAMORE

Nr. 18/3 prot

Tiranë, më datë 23/02/2021

Rregullore e Brendshme

e Grupit të Monitorimit, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu 2,nenit 5 dhe nenit 37 të ligjit në fjalë), ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “ Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ligjit nr.90/2012 “ Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të Urdhrit nr.6, datë 23.02.2021,” Për ngritjen e Grupit të Monitorimit”, të Kryetarit,

- ✓ me qëllim që te vendoset kontrolli mbi sjelljen e nëpunësve civilë në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike, në kushtet e zgjedhjeve lokale,
- ✓ për të siguruar parimin e meritës dhe paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i shërbimit civil (neni 5,Kreu II, i ligjit në fjalë),
- ✓ për të siguruar zbatimin e ligjit, në drejtim të respektimit të të drejtave politike,të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër te tjera, ndalohet pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike;
- ✓ si dhe për të siguruar vijueshmërinë normale dhe të pandikuar nga fushata zgjedhore, të veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë , në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, në këtë institucion,

Grupi i Monitorimit, harton këtë Rregullore të Brendshme e cila përcakton objektin e veprimtarisë së tij, si dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga

1

nëpunësi civilë, gjatë periudhës së fushatës elektorale, të cilat do të jenë edhe objekt i kontrollit të grupit *ad-hoc*, të ngritur në këtë rast.

Objekti i veprimtarisë së këtij grupi do të jetë sjellja e nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

Përbërja e grupit të punës: Grupi i Monitorimit do të përbëhet nga

- a. Zana Gliozheni, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve, Kryetare
- b. Klaudia Mullari, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve, Anëtare (Koordinatorë)
- c. Jetmir Skuka, Specialist në Sektorin e Analizës, Anëtar

Grupi i Monitorimit do të veprojë në bashkëpunim të ngushtë me eprorët direkt të nëpunësve civilë, si dhe me njësinë e administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të respektojë diskrecionin ligjor të këtyre subjekteve, në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj.

Puna për realizimin me sukses të objektivit të këtij grupi do të përqëndrohet në këto aspekte të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë nëpunësit civilë të institucionit:

1. Në një regjistër të posaçëm, i cili do të administrohet nga Grupi i Monitorimit, nëpunësit civilë duhet të shënojnë çdo ditë hyrje-daljet në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08.00-16.00.
2. Nga ana e Sektorit të Shërbimeve, duhet të shënohen në orën 08.00, të gjithë nëpunësit civilë që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.
3. Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listëprezenca e nëpunësve civilë do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.
4. Nëpunësit duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e telefonit, pranë njësisë së administrimit të burimeve njerëzore.

5. Eprorët direkt, duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mospasja dijeni për mungesë stafi, do të konsiderohet si mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.

6. Gjatë orarit zyrtar 08.00 deri në 16.00 ,nëpunësit civilë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër,për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.

Nëpunësi civilë nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët/ të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit/ të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit.

Nëpunësi civilë duhet të informojë grupin e monitorimit, në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

7. Pas orarit zyrtar, nëpunësi civilë, nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.

8. Grupi i Monitorimit do të organizojë kontrole në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.

9. Grupi i Monitorimit, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga ky grup, do të komunikojë çdo ditë me personin e kontaktit,pjesë e Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.

10. Grupi i Monitorimit do të ndjekë me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civilë në kundërshtim me ligjin.

11. Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit do t'i dërgojë për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë eprorit direkt ose pranë Komisionit të Disiplines, sipas rëndësisë së shkeljes së kryer.

Dispozitat e kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga grupi i monitorimit si dhe nga nëpunësit civilë të institucionit, të cilët duhet të njihen me këtë rregullore,nëpërmjet njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të mundësohet zbatimi i rregullave të vendosura në të, nga ana e tyre.

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga titullari i institucionit dhe është e vlefshme për periudhën zgjedhore, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 2021.

Veprimi në kundërshtim me rregulloren përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civilë.

GRUPI I MONITORIMIT

1. Zana Gliozheni, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve, Kryetare



2. Klaudia Mullari, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve, Anëtare (Koordinatore)



3. Jetmir Skuka, Specialist në Sektorin e Analizës, Anëtar

